



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 34.

Prishtinë, më 18.12.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti, Donika-Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

**Munguan:** Blerta Deliu Kodra dhe Adem Hoxha.

**Nga Staf i Mbështetës i Komisionit:** Ahtere Loxha, Adelina Demolli, dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerë: Përfaqësuesi nga KDI-ja dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi Armend Zemaj, nënkryetar i parë i Komisionit.**

**Rendi i Ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.11.2018 dhe 3.12.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuesit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
10. Të ndryshme.

**1. Miratimi i Rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.11.2018 dhe 3.12.2018;**

Procesverbalet nga mbledhjet mbajtura më 27.11.2018 dhe 3.12.2018, u miratuan pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Armend Zemaj, kryesues,** tha se fushëveprimi i këtij projektligji ndërlidhet vetëm me harmonizimin me dispozitat e legjislacionit vendor, përkatësisht me Ligjin për Kundërvajtje, prandaj çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj nuk janë ne kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë Kuvendit për miratim.

**Ismajl Kurteshi,** tha se do të abstenojë, sepse çështja e gjobave që është zvogëluar jashtëzakonisht shumë, dhe bëhet fjalë për objektet siç janë kinematë, ku mund t'ju ndërrohet dedikimi dhe dënimi prej 2000 euro, më është dukur shumë i padrejtë, sepse duhet t'i mbrojmë ato me një dënim më të madh.

**Armen Zemaj,** tha se jo vetëm ky ligj por edhe shumë ligje të tjera që bien në fushëveprimtarinë e Ligjit të ri për Kundërvajtje, sidomos në pjesën ku ndërlidhet me gjobat, duhet të jetë konform ligjit të ri. Nuk po e arsyetoj faktin e ndryshimeve, se a janë të përshtatshme gjobat sa i përket projektligjit, por pjesa e kundërvajtjes atje ka ndryshuar, pra, nuk ka dënime me burg për kundërvajtje si në te kaluarën, por shumat janë të rregulluara në bazë të specifikave, të cilat kalojnë në Ligjin për procedurën penale.

Pajtohem plotësisht që fushat që janë specifike e veçantë, është dashtë të trajtohen jo vetëm ne aspektin e gjobave, por edhe të dënimeve alternative, që i parasheh edhe Kodi Penal.

Pas diskutimeve, kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

#### **Rekomandim**

**Projektligji nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë ne kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë Kuvendit për miratim.**

**4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Armen Zemaj, kryesues,** tha se fushëveprimi i këtij projektligji ndërlidhet vetëm me harmonizimin me dispozitat e legjislacionit vendor, prandaj çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, nuk janë ne kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohen për miratim ne Kuvend.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, pas votimit kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

#### **Rekomandim**

**Projektligji nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë ne kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.**

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryesuesi,** tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, pas votimit, u konstatua se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

#### **Rekomandim**

**Projektligji nr. 06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë ne kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.**

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryesuesi**, tha se fushëveprimi i këtij projektligji ndërlidhet vetëm me harmonizimin me dispozitat e legjislacionit vendor, prandaj çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, pas votimit, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

**Projektligjit nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.**

**7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Armend Zemaj, kryesues**, tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, pas votimit, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

**Projektligji nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.**

**8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryesuesi**, tha se çështjet e rregulluara dhe adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, pas votimit, Komisioni me 4 vota për dhe 5 abstenime, nxori këtë:

**Rekomandim**

**Projektligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk miratohet nga Komisioni .**

**9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryesuesi**, tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, pas votimit, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

#### **Rekomandim**

**Projektligji nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tillë mund t'ia rekomandojmë për miratim Kuvendit.**

#### **11. Të ndryshme.**

Pasi nuk pati të paraqitur për diskutim, kryesuesi e përfundoi mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit**

**Nënkryetar i parë i Komisionit,**  
**Armend Zemaj**

-----